

VLERA DHE RËNDËSIA E MUHIMME-I DEFTERËVE

1. Ç'janë defterët osmanë?

Defterët osmanë të quajtur “Muhimme Defter-i”, janë defterë apo fletushka që ngërthejnë problemet e sektorit ushtarak në Shtetin Osman. Këto ishin probleme të ndryshme aktuale që paraqisnin mënyrat dhe funksionimin e sistemit dhe punëve të tyre shtetërore në sektorë të ndryshëm. Këta janë defterët më me ndikim në udhëheqjen shtetërore të Perandorisë Osmane. Në këto fletushka përshkruhen aktivitetet shoqërore, organizimi dhe administrimi i tyre, përfillja e dispozitave ligjore etj.

Këto dokumente përmbajnë njohuri të rëndësishme për shtetet fqinje të kësaj Perandorie, si: shtetet e Evropës fqinje, Afrika Veriore, Lindja e Mesme, Gadishulli Arabik, shtetet e Kaukazit dhe Rusia. Për historinë e këtyre shteteve, këto dokumente paraqesin prioritet të madh. Këto dokumente, gjithashtu, përmbledhin edhe çështjet e jomuslimanëve që ishin nën qeverisjen osmane, të drejtat e të shtypurve, organizimin e politikës që përmbledhte sigurimin e nevojat socialekonomike, lirinë e kryerjes së ritualeve fetare, ushtrimin e lirë të të drejtave fetare, ndërtimin e vendeve të adhurimit- kultit etj. Me një fjalë, këto janë pikat kryesore të cilat i rastisim nëpër këta defterë.

Në defterët osmanë përshkruhet edhe organizimi i Haxhit në vendet e Shenjta, përmendet se nga Padishahu ndahej një shumë e të hollave për nevojtarët që dëshironin të bënin Haxhin, d.m.th. për vizitën e Mekës dhe Medines. Kjo metodë në Qeverinë Osmane quhej Sure-i Hymajun. Kjo nevojë dhe ky organizim, pra sure, zinte një kapitull të posaçëm në këta defterë.¹

Kësisoj, këta defterë përmbledhin kulturën, zejet dhe aktivitetin osman, politikën e ndërtimit dhe banimit brenda kësaj Perandorie,

shërbimet komunale dhe ato të rrethit, punët e shëndetësisë dhe të edukimit, problemet që kishin të bëjnë me vakëfet dhe administrimin e inspektimin e tyre. Në të gjitha këto lëmi, këta defterë paraqesin një shtjellim të pasur i cili shpjegon gjerësisht aktivitetin dhe funksionimin e Perandorisë Osmane dhe vendet që ajo i kishte nën qeverinë e saj.

Numri i fletushkave të Myhimme-i Defterëve është i shumtë. Ato përmbanin me shumicë divanin ushtarak - kronologjinë e problemeve dhe organizimeve ushtarake, shërbime luftarake gjatë historisë dhe shërbime të tjera logjistike, shërbime këto të cilat në regjistrime historike merren si burime të shkallës së parë.

Në Arkivin Shtetëror të Turqisë pranë Kryeministrisë këta defterë janë të regjistruar në katalog nga 989 numra. Numrat e fillimit deri në numrin 73 të Myhimme-i Defterëve përmbajnë dispozita të veçanta që janë të radhitura veçmas apo ndarazi nga numrat 20, 54, 66 dhe 72.

Në fund, numrat 3, 5, 6, 7, 12 dhe 82 në defterët Myhimme-i Defter janë shtypur dhe janë indeksuar nga ana e Arkivit Osman të Turqisë pranë Kryeministrisë.

Këta defterë janë plotësuar zakonisht në Këshillin Shtetëror të Sulltanit. Myhimme-i Defterët, gjithashtu, kryenin edhe punë të përgjithshme dhe të precizuara duke përfshirë dispozitat dhe fermanët (urdhurat) kryesorë. Në Arkivin Shtetëror të Turqisë pranë Kryeministrisë ndodhen Myhimme-i Defterët e viteve 961/1323 dhe 1553/1905. Në Arkivin Shtetëror të Turqisë gjenden 263 faqe të Myhimme-i Defterëve. Në radhët e këtyre faqeve ndodhen, gjithashtu, edhe sixhilët e Sheriatit (Jurisprudencës Islame). Në këtë Arkiv mungon numri 20 i Myhimme-i Defterëve. Këta defterë, po ashtu, gjenden edhe në Arkivin Shtetëror të Turqisë në Kepexhi, nr. 70 dhe 71 në vitet 950- 960/ 1551-1553. Ndërsa në muzeun e Topkapisë gjenden Muhimme-i Defterët e viteve 951- 952/ 1544-1546. Gjithashtu, nuk mund të anashkalojmë se këta defterë edhe janë shpërndarë (14 numrat në mes të viteve 990- 159/ 1572- 1746).

Nga këta defterë janë bërë hulumtime të shumta sikurse përmendëm edhe më lart. Ata përfshinin të gjitha tokat osmane dhe nevojat brenda tyre duke filluar nga çështjet e administrimit, ato sociale, kulturore, etnike, fetare, legislative, të vakëfeve etj. Është për të ardhur keq që deri në ditën e sotme asnjë Myhimme-i

Defteri nuk u botua prej fillimit e deri në fund, edhe pse ky ishte materiali kryesor i sistemit të burokracisë osmane.

Nëse mendohet të nxirren në pah të vërtetat e qeverisjes, ekonomisë dhe shoqërisë së Shtetit Osman, nevojitet studimi i këtyre burimeve, që llogariten si burim i dorës së parë.

Këta defterë përfshijnë kohën prej mesit të shekullit të 16-të deri në fillimin e shekullit të 20, d.m.th. një periudhë prej 350 vjetësh me ngjarje dhe ndodhi të rëndësishme historike. Mund të themi se këta defterë paraqesin një pasuri të madhe kulturore dhe historike të cilën nuk mund ta hasësh në asnjë vend të lindjes apo perëndimit.

Myhimme-i Defterët përmbajnë edhe historinë e Lindjes së Afërt dhe të Mesme, si dhe të shteteve Ballkanike dhe janë ruajtur origjinalë deri më sot. Kjo dëshmon edhe njëherë edukatën dhe kujdesin e lartë të Shtetit Turk dhe është dëshmi se ishte superfuqi e suksesshme botërore. Dihet shumë mirë se vlerat e një populli ruhen vetëm kur është e ruajtur dhe e regjistruar e kaluara e tij historike.

Këta defterë shënoheshin nëpërmjet të qatipëve (shkruesve), me dorën e tyre, pas çdo tubimi, mbledhjeje dhe diskutimi financiar, administrues tradicional në oborrin e Padishahut (Divan-i Hymajun- Këshilli Shtetëror i Sulltanit). Këto shkrime, më vonë, i analizonin. Ato recensoheshin nga krerët e qatipëve (Reisu'l Kuttab- Kryetarët e Qatipëve). Më pastaj shënoheshin vendet e nevojshme dhe, më në fund, nga ana e nishanxhiut (shënuesit që e vuloste), i jepej vula e dispozitës apo e vlefshmërisë dhe e urdhrit (ferman). Punët që kërkoheshin nga Porta e Lartë (Bab-i Ali), së pari drejtoheshin në Këshillin Shtetëror të Sulltanit dhe përmes Defter-i Myhimmeve transferoheshin deri te Porta e Lartë (Bab-i Ali).

Myhimme-i Defterët janë disa lloje. Lloji i parë është ai normal ose i qartë: Gjatë diskutimeve në Divan-Oborrin e Sulltanit. Lloji i dytë i tyre është "Mektum Myhimme Defter-i", i cili përmbledh ligje (hykym) dhe urdhra (fermanë) të fshehtë. Këso Myhimme-i Defteri na paraqiten nga shekulli XVII. Defterët e quajtur "Ordu Myhimmesi" - Fletoret kryesore ushtarake, janë defterët që janë nevojitur gjatë kohës së luftërave, në mbledhjet dhe diskutimet që i bënin Sadrazami dhe Komandanti Kryesor (gjeneralejtnant)-

(Serdar-i Ekrem). Kur Sadrazami ndodhej në udhëtim, kryesia, e cila përfaqësonte postin e tij dhe mbante mbledhje, quhej “Rikab-i Hymajunë”, d.m.th. Këshilli që tubohej nën kryesinë e Kajmakamit. Shënimet nga këto mbledhje shkruheshin në defterët e quajtur “Rikab Myhimmesi”. Ata mund t’i radhisim në katër grupe si vijon:

1. Myhimme-i Defter-i: Shënimet që regjistroheshin nëpër Myhimme-i Defterë gjatë seancave nga ana e Padishahut dhe kryesisë së Sadrazamit.
2. Rikab Myhimmesi: Kur Sadrazami dilte në udhëtim apo ndahej nga kryesia për ndonjë arsye tjetër, në atë rast postin e tij e zëvendësonte Kajmakami Kryesor që quhej Rikab ose Sadaret Kajmakami. Vendimet që merreshin nga këto seanca brenda Këshillit të Sulltanit, regjistroheshin në defterët që quheshin “Rikab Myhimmesi”.
3. Ordu Myhimmesi - Regjistrat Kryesorë Ushtarakë: Kur Sadrazami dilte së bashku me ushtri në udhëtim, hidheshin shënime nga mbledhjet e mbajtura në këtë Këshill (Divan). Këta regjistra, që përmbanin vendimmarrje dhe marrëveshje mes palëve, regjistroheshin në defterët e quajtur “Ordu Myhimmesi” - Regjistrat Kryesorë Ushtarakë.
4. Myhimmeja e Kajmakamllëkut-Kajmakamllik Myhimmesi - Regjistri Kryesor i Kajmakamllëkut: Kur për një kohë të njëjtë largoheshin nga Stambolli (Derseadet) edhe Padishahu, edhe Sadrazami, Kajmekami, i cili emërohej për administrimin e punëve shtetërore, miratonte marrëveshje që shënoheshin në këta regjistra. Ata janë defterë në formë beratesh dhe fermanësh. Anëtarët që bënë pjesë në kryesinë e Sadrazamit, si: vezirët, kazaskerët e Anadollisë dhe të Rumelisë, defterdarët (shënuesit), nishanxhinjtë (vulosësit), kur merrnin pjesë në mbledhjet e Divanit të Këshillit Sulltanor, vendimet që merreshin këtu, pas amiratimit nga ana e Sulltanit, i regjistronin në mënyrë kronologjike në defterë.

Regjistrat që paraqisnin këta defterë, qofshin vendime apo ankesa, së pari formuloheshin në formë të fermanëve, përmirësoheshin dhe recensoheshin mirë. Nëse kishte pasur diçka të nevojshme dhe nuk ishte regjistruar, atëherë nuk paraqiste rëndësinë e dispozitës së rregullt.

Që të rregullohej ose të prishej një regjistër, bëhej kryekëput me lejen e Padishahut. Nëse dëshironte që të përmirësonte diçka nishanxhiu, në vitet e para ky ishte prijës i lapsave, d.m.th. kishte një pozitë shumë të lartë, por prapë nuk mund të ndryshonte asgjë, sepse ishte i porositur nën moton dhe ishte e mundur me fermanin e quajtur "Vetëm Padishahu me pendën e vet mund të bëjë përmirësime". Kur ndonjë dispozitë bëhej e zhvlerësuar, duhej që kjo leje të merrej nga Hatt-i Hymajunë - Oborri Sulltanor dhe Emr-i Ali- Urdhri i Lartë i Sulltanit, që së pari të zhvlerësohej e para "terkinë", ose fermanin e regjistruar më parë ta çregjistronte duke e bërë të çautorizuar, "shakk". Kjo formë paraqitej kur nëpër këto dokumente, në rreshtat e poshtëm, vijëzoheshin të zhvlerësuarat dhe në të tri anët e faqeve jepeshin shpjegimet e atyre që e lejonin këtë ndryshim, ku thuhej: "sipas nevojës së Sulltanit" apo "Sipas kërkesës (miratimit) të Sulltanit" ose "Në kapitullin e zhvlerësimit nevojitet ndryshimi sipas urdhrin të Sulltanit", "Kërkon rregulloren e ndryshimit".

Myhimme-i Defterët, shikuar në përgjithësi, nuk kanë radhitje të klasifikuar, ndërsa në sy të parë duket se plotësojnë njëri-tjetrin. Dokumentet të cilat i takojnë periudhës klasike të viteve 1553-1642, nuk përmbajnë tituj. Kanë janë shkrime të stërpërzierë. Në fillim të faqeve, në vend të titullit figuron dita kur është mbajtur mbledhja dhe dita e muaji të shkruar në arabisht.

2. Defteri-i Muhimmet e Arkivit Shtetëror të Kosovës

Në Arkivin Shtetëror të Kosovës, në kutinë nr. 1, janë të përmbledhura një sërë dokumentesh të viteve² 1556-1600. Pra kemi dokumente të viteve të ndryshme, por më me shumicë janë ato të viteve 950-1000 Hixhri. Ky është edhe një argument se këto dokumente ishin nga më të përhapurat, kur Perandoria Osmane ishte në lulëzimin më të lartë.

Vula nëpër këto dokumente zakonisht figuron e shënuar sipas muajit dhe vitit hixhri. Shënimi i viteve ndonjëherë vërehet e ndonjëherë nuk vërehet fare, por ka raste kur figurojnë vetëm dy shifra.³

Në Defter-i Muhimme janë një sërë përmbledhje dokumentesh dhe lutje të ndryshme, ku secila ka përmbajtje të ndryshme. Aty

ka më së shumti lutje ushtarake (askerijje- ser asker) dhe shënime të oficerëve apo eprorëve ushtarakë. Gjithashtu, nëpër këto dokumente ka edhe shënime rreth xeheve (madeneve) të cilat e precizojnë tokën, vlerën e saj, kultivimin, madhësinë e cila matej me njësinë matëse osmane të asaj kohe, që quhej “okë”.⁴

Gjithashtu, në Defter-i Muhimme kemi edhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me ankesa, kërkesa dhe lutje të qytetarëve. Në këto dokumente kemi edhe fletë që tregojnë sasinë e harxhimeve dhe gjithçka tjetër që lidhet me nevojat e popullit. Këto dokumente zakonisht i përmbaheshin ligjit të drejtë të Sheriatit e që Sulltani urdhëronte që ky ligj të zbatohet me përpikëri. Ligji i Sheriatit është ligji i cili me ngulm i përmbahet: drejtësisë, humanitetit dhe vëllazërimit.⁵

Këta defterë janë të shënuar gjithashtu edhe me numra.

Në Arkivin Shtetëror të Kosovës ndodhen deri në numrin 44.⁶

Më poshtë do t’i paraqesim sipas radhitjes së numrave të tyre:

1. Defter-i Mühimme

Min Availi-i Ramadan sene 961 H⁷. Ila avail-i Rebiü’l evvel sene 963 H.

Defter-i Myhimme⁸

Prej fillimit të muajit Ramazan viti 961 H., deri në fillimin e muajit Rebiul Evvel viti 963.⁹

2. Defter-i Mühimme

Min evasit-i Zi’l Hicce sene 994 H. ila Avail-i Rebiü’l Ahir sene 1000 H.

Defter-i Myhimme

Prej mesit të muajit Dhil Hixhxhe viti 994 deri në fillim të muajit Rebiul Ahir, viti 1000 H.

3. Defter-i Mühimme

Fi Avail-i Safer sene 995 H. ila evasit-i Şa’ban sene 996 H.

Defter-i Myhimme

Prej fillimit të muajit Safer viti 995 H. Deri në mesin e muajit Sha’ban viti 996 H.

4. Defter-i Mühimme
Min Avahir-i Ramadan sene 993 H. ila sene 99...H.
Defter-i Myhimme
Prej fundit të Ramazanit të vitit 993 H. deri në vitin 99..H

5. Defter-i Mühimme
Min avahir-i Rebiü'l Evvel sene 1127 H. ila evasit-i Zi'l Hicce sene 1201 H.
Defter-i Myhimme
Prej fundit të muajit Rebiul Evvel të vitit 1127 H.
deri në mesin e muajit Dhil Hixhxhe të vitit 1201 H.

6. Defter-i Mühimme
Min avail-i Ramadan sene 991 ila avahir-i Ramadan sene 992 H.
Defter-i Myhimme
Prej fillimit të muajit Ramazan të vitit 991 deri në fund të muajit Ramazan të vitit 992 H.

7. Defter-i Mühimme
Min avail-i Receb sene 990 H. ila evasit-i Rebiü'l Ahir sene 991 H.
Defter-i Myhimme
Prej fillimit të muajit Rexheb të vitit 990 H. deri në mesin e muajit Rebiul Ahir të vitit 991 H.

8. Defter-i Mühimme
Min evasit-i Safer sene 990 ila avahiri Zi'l Hicce sene 990 H.
Defter-i Myhimme
Prej mesit të muajit Safer të vitit 990 deri në fund të muajit Dhil Hixhxhe të vitit 990 H.

9. Defter-i Mühimme
Min evasit-i Receb sene 989 H. ila evasit-i Saferü'l Hayr sene 990 H.
Defter-i Myhimme
Prej mesit të muajit Rexheb të vitit 989 H. deri në mesin e muajit Seferul Hajr të vitit 990 H.

10. Defter-i Mühimme

Min evasit-i Cumadiye'1 Ahar sene 989 H. ila avail-i Zi'l Ka' de sene 989 H.

Defter-i Myhimme

Prej mesit të muajit Xhumadijel Ahar të vitit 989 H.

deri në fillimin e muajit Dhil Ka' de të vitit 989 H.

Etj.

Shënime:

¹ Dihet mirë se organizimi dhe shkuarja në Haxh, zakonisht bëhej me deve, duke pasur parasysh se deveja është shtazë e cila përballon udhëtimin dhe ushqimin e pijet një kohë më të gjatë.

² Kutija Nr: 1, viti 1555- 1556, marrë nga depo në Arkivin Shtetëror të Kosovës, lloji i dokumenteve mikrofilm. Kopje nga Arkivi Shtetëror i Turqisë. Regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

³ Op i cituar, dëshmi sipas dokumenteve të sipërpërmendura.

⁴ Op i cituar, dëshmi sipas dokumenteve të sipërpërmendura.

⁵ Op i cituar...

⁶ Op i cituar...

⁷ Në shumicën e rasteve vitet shënohen sipas kalendarit Hixhri, por nuk përjashtohen rastet kur vitet shënohen me kalendarin Miladi.

⁸ Op. i cituar

⁹ Përkthim i domethënies dhe limitimit të këtyre dokumenteve.